124/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 772/1 Prot Tiranë, më 07/09/2015

Lënda: Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare

Drejtuar: **BASHKISË KËLCYRË**

Këlcyrë

Për dijeni: **QENDRËS "RES PUBLICA"**
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3,Kati 9, Apt.44

Tiranë

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është depozituar ankesa nr. 772 Prot., datë 07.09.2015, nga Qendra "Res Publica" me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
Ankuesi nëpërmjet shkresës nr.125/15 Prot., datë 29.07.2015, ka kërkuar nga Bashkia Këlcyrë t'i vihet në dispozicion informacion me shkrim si dhe të pajiset me kopje të dokumenteve zyrtare si më poshtë:

1. Sa banesa sociale ka shpërndarë Bashkia në 5 vjeçarin e fundit dhe sa banesa sociale ka në dispozicion (të lira për t'u shpërndarë)?
2. Sa është numri i aplikuesve për programet sociale gjatë vitit 2014, për secilin nga programet e strehimit?
3. Sa familje kanë përfituar nga programet sociale të strehimit gjatë vitit 2014 dhe në cilat programe? Sa nga familjet që kanë përfituar, i përkasin komunitetit rom, për secilin nga programet e strehimit?
4. Si është zbatuar programi social i strehimit "pajisje e truallit me infrastrukturë" dhe cilat janë parashikimet e bashkisë lidhur me programin "Për pajisjen e truallit me infrastrukturë" në terma afatgjatë dhe afatmesëm?
5. Ligji për programet socialet strehimit parashikon që familjet rome duhet të trajtohen me prioritet në përfitimin nga programet sociale të strehimit (neni 26, pika 2 e ligjit nr.9232/2005). Gjithashtu akti normativ nr.3, datë 01.08.2012 miratuar me ligjin nr.82/2012, parashikon që kategorisë së qiramarrësve, që kanë banuar në banesat ish shtetërore të kthyera pronarëve, duhet t'i vihet në dispozicion jo më pak se gjysma e kuotave. A merret parasysh ky detyrim ligjor gjatë pikëzimit të familjeve përfituese?
6. Sa është buxheti i bashkisë për programet sociale të strehimit për vitet 2014, 2015?
7. Sa është parashikuar buxheti për vitin 2016 në lidhje me programet sociale të strehimit?
8. A keni aplikuar ndonjëherë , pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për të përfituar nga programi social i grandit të vogël, i destinuar për strehimin e familjeve rome?

Pas refuzimit të dhënies së informacionit, ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.
Komisioneri vlerëson se, Bashkia Këlcyrë detyrohet sipas nenit 14 dhe 16 të ligjit, të informojë ankuesin lidhur me kërkesën e tij. Në rast të kundërt ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18/2/a/ë/g të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", *"a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë". ë) mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë; g) mosnjoftimi i kërkuesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjetër, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.*
Në kushte të tilla, përpara marrjes së vendimit, Komisioneri kërkon të trajtoni kërkesën dhe të vlerësoni dhënien e informacionit të kërkuar brenda datës 15.09.2015. Në rast mosveprimi nga ana juaj brenda afatit të përcaktuar (datë 15.09.2015), Zyra e Komisionerit do të vlerësojë mbi ndjekjen e procedurës së mëtejshme në përputhje me nenin 18 dhe 24 të ligjit nr. 119/2014.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit sjell në vëmendjen tuaj se, ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në nenin 4 të tij, ka përcaktuar që Autoritetet Publike, brenda datës 4 Maj 2015, duhet të hartonin dhe miratonin programet e transparencës.

Duke qenë se, përmbushja e këtij detyrimi ka tejkaluar afatet, kërkohet angazhim maksimal nga ana juaj, për të hartuar dhe miratuar këto programe. *Programi model* i transparencës është botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, datë 28.01.2015 si dhe publikuar në faqen e internetit www.idp.al.
Mospërmbushja e këtij detyrimi sanksionohet me gjobë në kuptim të gërmës b, të pikës 2 të nenit 18 të Ligjit "Për të drejtën e informimit".
Për çdo informacion mund të kontaktoni në adresën info@idp.al .

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI